



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government



Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense

Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Direktorat Ljudskih Resurs/Human Resources Directorate

Duke bazuar në Rregulloren Nr.07/2023 për Rekrutim në FSK, Ministria e Mbrojtjes shpall:

K O N K U R S

Për rekrutimin e 300 ushtarëve aktiv të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Kriteret e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plot për të vepruar;
- Të ketë të përfunduar shkollën e mesme (dëshmi) për kandidat për rekrut/ushtar;
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme shëndetësore dhe fizike për vendin e shërbimit;
- Të mos jetë i dënuar për vepër penale, me vendim të formës së prerë.
- Të jetë tetëmbëdhjetë vjeç (18) në ditën e mbylljes së konkursit.
- Të mos jetë më i vjetër se njëzet e pesë vjeç (25) në ditën e mbylljes së konkursit;
- Kandidatët meshkuj duhet të kenë gjatësinë trupore jo më pak se 165cm, ndërsa femrat duhet të kenë gjatësinë trupore jo më pak se 160cm (kjo verifikohet gjatë fazës së testimit fizik).
- Kandidatët të cilët bartin tatuazhe në fytyrë, qafë dhe parakrahë nga pjesa e bicepsit deri te gishtat e dorës, duke përfshirë edhe pirsingun, në rast të përzgjedhjes janë të obliguar të bëjnë heqjen e tyre paraprakisht në afatin kohor deri në trajnimin bazik në të kundërtën diskualifikohen.

Testimet për ushtar:

- Testi fizik;
- Testi i inteligjencies;
- Testi i njohurive të përgjithshme;
- Intervista;
- Ekzaminimi shëndetësor.

Kalimi me sukses i testit paraprak është kusht për të drejtën e testimit në fazën vijuese, me përjashtim të testit të inteligjencës dhe testit të njohurive të përgjithshme, të cilët realizohen në të njëjtën kohë.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Diploma e shkollës së mesme, (diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës, duhet t'i nënshtrohen procesit të njohjes nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë);
- Ekstrakti i lindjes (jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Certifikata nga gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetime penale (dokumenti të jetë i nxjerrë brenda afatit të konkursit);
- Vërtetimi nga Policia e Kosovës për të kaluarën e tyre penale (dokumenti të jete i nxjerrë brenda afatit të konkursit);
- Kopje të letërnjoftimit apo pasaportës;
- Foto portret 4x4 për aplikim (elektronike);
- Dëshmi për kualifikime tjera (nëse posedon).

- Dokumenti i zotësisë së veprimit (ky dokument kërkohet para se të fillojë trajnimi bazik)

Shënim: Kandidatët duhet të ofrojnë informata të sakta gjatë procesit të rekrutimit. Dhënia e informatave të rrejshme kurdo që zbulohet, gjatë procesit të rekrutimit apo gjatë shërbimit në FSK, rezulton me largim nga FSK-ja.

E drejta në ankesë

- Të drejtën e ankesës e ka çdo kandidatë pas marrjes së rezultateve të çdo faze të testimit përkatës;
- Rezultatet publikohen në Ueb-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së dhe kandidatët e eliminuar kanë të drejtë ankese brenda afatit dy (2)- ditor;
- Afati i ankesës rrjedh ditën pasuese pas publikimit të rezultatit;
- Ankesa dorëzohet përmes e-mallit në Zyrën e Rekrutimit;
- Bordi Përzgjedhës në afat prej 2 ditësh shqyrton dhe merr vendim për ankesën.
- Në rastet kur Bordi Përzgjedhës vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, e aprovon ankesën me të drejtë të kalimit në fazën tjetër ose ri-testimit;
- Kur Bordi Përzgjedhës vlerëson se ankesa është e pabazuar, ankesën e përcjellë te Bordi për Shqyrtim të ankesave, me sqarimet përkatëse, brenda afatit dy (2) ditor të punës nga pranimi i ankesës.

Pranimi në FSK;

- Pranimi në FSK bazohet në gjendjen shëndetësore dhe fizike sipas nevojave e prioriteteve të FSK-së dhe pas përfundimit me sukses të procedurës së verifikimit të sigurisë, respektivisht pastërtisë së figurës, të përcaktuar me Rregulloren e Pastërtisë së Figurës për pjesëtarët e FSK-së të nxjerrë nga Ministri. Pranimi në Forcën e Sigurisë së Kosovës bëhet si rekrutë për kategorinë e ushtarëve dhe konfirmohet pas përfundimit të trajnimit bazik, gjatë së cilës kohë, kandidatët do të cilësohen si rekrutë (OR1).

Afati i aplikimit;

- Konkursi do të jetë i hapur prej **09.09.2024** deri më **08.10.2024**, ora **23:59**.

Si të aplikoni;

Aplikimi dhe njoftimi për përzgjedhjen e kandidateve është online në adresën <https://rekrutimi.fsk-rks.org/Apply> si dhe njoftimi për shpalljen e konkursit mund ta shikoni edhe në web faqen e MM-së, <https://mod.rks-gov.net>, ku gjendet shpallja e konkursit. **Kandidatët plotësojnë formularin e aplikimit online <https://rekrutimi.fsk-rks.org/Apply> dhe bashkëngjisin të gjitha dokumentet tjera të kërkuara nga ky formular.** Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në ditën e fundit të përmbylljes së konkursit. Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr. tel. 038- 555584 5690 dhe 038- 555584 5691 nga ora 09:00 deri 15:00.

Ministria e Mbrojtjes mirëpret aplikacionet e femrave dhe meshkujve pa dallim nga përkatësia e tyre etnike.